

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Serbia shfaq robotë të armatosur disa ditë pas hapjes së fabrikës kineze
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajoni/serbia-shfaq-robote-te-armatosur-disa-dite-pas-hapjes-se-fabrikes-kineze-i587117
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 15:25:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 16:55:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e4fc70d2c6b6da5a8b8c0df763fc886e1b3ab258f50bd02afc70e64506b0ea68
TEKSTI	25d5c4d2597d78977c120a46919045595b8f264427ccd42667a8b2d54dcc953e
PAMJA	198cb8d4522931988983a8866b20973c20e77f2a8a29194b46ef9a553df581e9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b6e66ba0ac2dee0a44014875906773cf01da9440d7a8c04b86715ea39a31ae08
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b6e66ba0ac2dee0a44014875906773cf01da9440d7a8c04b86715ea39a31ae08>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



19 Shtator 2026, 18:55Rajoni TEMA

Serbia shfaq robotë të armatosur disa ditë pas hapjes së fabrikës kineze



19 Shtator 2026, 18:55Rajoni TEMA



Dy javë pasi Serbia e hapi një fabrikë që prodhon robotë të projektuar nga Kina, ushtria serbe ka shfaqur robotë të armatosur katërkëmbësh duke vepruar së bashku me ushtarët gjatë një stërvitjeje të madhe ushtarake.

Përdorimi i robotëve më 13 shtator erdhi pasi presidenti serb, Aleksandar Vuçiç, u zotua më 29 gusht se robotët e armatosur, të projektuar nga Kina dhe që do t'i shërbenin ushtrisë së Beogradit, do të shiheshin "brenda 15 ditësh" nga hapja e fabrikës së robotëve në Shabac, në Serbinë perëndimore.

Robotët e armatosur katërkëmbësh ngjajnë me modelin D1 Max Pro, një robot industrial i prodhuar nga kompania kineze AgiBot, e cila është partnere në fabrikën e Shabacit. Megjithatë, mbetet e paqartë nëse robotët e shfaqur gjatë stërvitjes janë montuar në Serbi. Ushtria serbe nuk iu përgjigj pyetjes së Radios Evropa e Lirë se ku janë prodhuar qentë robotë.

Sipas raportimeve, robotët katërkëmbësh të përdorur gjatë stërvitjes ushtarake "Victor 2026" në jugperëndim të Serbisë ishin të armatosur me raketa antitanke "Wasp", të dizajnuara në Jugosllavi, pushkë automatike dhe granatahdhës 40-milimetërsh. Pamjet tregojnë robotët katërkëmbësh duke qëlluar me një armë automatike dhe duke hyrë në një ndërtesë të improvizuar, ndërsa ushtarët lëvizin përkrah tyre.

Fabrika e robotëve në Shabac synon t'i prodhojë 3.000 robotë humanoidë dhe katërkëmbësh në vit, dhe pamjet nga stërvitja ushtarake kanë ngritur shqetësimin për shfaqjen e ushtrive me qen robotë vrasës nga Ballkani. Por, sipas vëzhguesve, kjo nuk duket e mundshme në një të ardhme të afërt.

"Serbia me gjasë do të përballet me të njëjtat probleme që i kanë shtyrë ushtritë ta rishqyrtojnë përdorimin e qenve robotë", tha për Radion Evropa e Lirë Jared Keller, ekspert amerikan i teknologjisë së armëve.

"Krahasuar me platformat e tjera pa ekuipazh, robotët katërkëmbësh duhet të zhvillohen akom më shumë" për t'i tejkaluar problemet që lidhen me besueshmërinë dhe rrezën e veprimit", shtoi ai.

Ushtria ukrainase mori vëmendje të gjerë pasi publikoi në gusht të vitit 2024 të dhëna për përdorimin e qenve robotë nga ushtarët e saj. Por, gjatë dy vjetëve që pasuan, robotët janë parë rrallë në fushëbetejë. Gjatë së njëjtës periudhë, dronët tokësorë me rrota janë përdorur gjerësisht nga trupat në vijën e frontit.

Qentë robotë janë shumë më kompleksë mekanikisht sesa dronët me rrota, pasi secili robot katërkëmbësh ka nevojë për rreth 12 motorë të veçantë, së bashku me një grup kompleks sensorësh. Ky kompleksitet mekanik shpenzon bateritë, rrit mundësinë e prishjeve dhe shton kosto teknologjike. Robotët katërkëmbësh kushtojnë dhjetëra mijëra dollarë dhe do të ishin shënjestër e lehtë për dronët e lirë sulmues.

Zbulimi nga Serbia i teknologjisë së robotëve katërkëmbësh vrasës vjen në një kohë kur Beogradi po përfshin gjithnjë e më shumë sisteme të avancuara kineze

te armeve ne arsenalin e ushtrise se tij, pertshire sisteme raketore dhe drone ajrore. Gati 60 per qind e importeve te armeve te Serbise gjate viteve 2020-2024 erdhen nga Kina.

Si Bashkimi Evropian, ashtu edhe Shtetet e Bashkuara kanë lënë të kuptohet se kanë shqetësime të shtuara për atë që Pekini dhe Beogradi e quajnë “miqësi të çeliktë”.

Një zëdhënës i Departamentit amerikan të Shtetit i tha Shërbimit të Ballkanik të Radios Evropa e Lirë se “mundësitë e ardhshme ekonomike të Serbisë do të varen në masë të madhe nga investimet, vendimet politike dhe zgjedhjet për partneritet që ajo bën sot”.

Zëdhënësi i bëri thirrje më tej Beogradit të zgjedhë “burime dhe furnizues të besueshëm të pajisjeve dhe teknologjisë së inteligjencës artificiale” dhe të zgjedhë “partnerë të besueshëm, si Shtetet e Bashkuara”.

Keller thotë se shfaqja publike nga Serbia e robotëve katërkëmbësh vrasës mund të ketë të bëjë më shumë me perceptimin gjeopolitik sesa me strategjinë reale të luftimit.

“Udhëheqësit e nivelit të mesëm shpesh nxjerrin në pah armë të avancuara për të sinjalizuar aftësitë teknologjike, edhe kur këto sisteme nuk mbështeten gjithmonë nga taktika dhe doktrina të përcaktuara, të cilat janë themeli i operacioneve reale”, tha ai.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Pas 27 vitesh identifikohen tri viktima nga varrezat në Zubin-Potok, Kurti: I përkasin “Grupit të Intelektualëve”](#)

16:15 Rajoni / 1 koment

[“Haga”: Mandati i Dhomave të Specializuara varet nga BE](#)

12:25 Rajoni / 10 komente

[Greçia, plan për rripopullimin e Çamërisë: 10 mijë € për familjet e Filatit, Sulit, Konicës dhe Pogonit](#)

10:45 Rajoni / 41 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.